



FOREVER®

Privacy Notice

Last updated: December 18, 2024

TABLE OF CONTENTS

Rreth Nesh.....	2
Informacioni Që Mund Të Marrim Prej Jush	2
Informacione Të Tjera Që Ne Mund Të Mbledhim Rreth Jush.....	3
Informacioni Që Ne Marrim Nga Burime Të Tjera	4
Cookies.....	4
Nxjerrja E Të Dhenave Tuaja	4
Ku I Ruajme Ne Të Dhënat Tuaja Personale	6
Aksesi, Kontrolli Dhe Të Drejtat Tuaja.....	7
Politikat E Informimit Online Mbi Femijët.....	7
Rregullat Për Mbrojtjen E Të Dhënave Të Përgjithshme	8
Të drejtat e privatësisë specifike të SHBA.....	8
Lei Geral de Proteção de Dados Nr. 13.709 / 2018 ose Ligji i Përgjithshëm për Mbrojtjen e të Dhënave (LGPD – Brazil).....	12
The Ley Federal de Protección de Datos Personales en Posesión de los Particulares (LFPDPPP – Mexico).....	12
Akti i Privatësisë nr. 119 1988 (Akti i Privatësisë - Australi)	12
Ligji i Kanadasë për Mbrojtjen e Informacionit Personal.....	12
Akti i Mbrojtjes së të Dhënave Personale Dixhitale të Indisë (DPDPA) 2023.....	12
Përdorimi i inteligjencës artificiale (AI).....	13
Ndryshimet Në Njoftimin Mbi Ruajtjen E Privatësisë Tonë	14
Politika e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve	14
Na Kontaktoni.....	<u>15</u>

Njoftime Ligjore: Duke vizituar secilin prej websiteve të Forever Living Products (këtuemëpas “FLP”) që përmban këtë Njoftim mbi Privatësinë, ju pranoni dhe dakordsoni plotësisht me praktikën përshkruar në këtë Njoftim mbi Privatësinë.

Rreth Nesh

FLP, themeluar në 1978 me zyra në Scottsdale, Arizona, është rritësi, prodhuesi dhe shpërndarësi më i madh i Aloe Veres në botë. FLP, vepron në më shumë se 150 vënde, është vertikalisht e integruar, duke kontrolluar çdo gjë nga fusha, tek fabrika, te kërkimi dhe zhvillimi, tek ambalazhimi, postimi dhe shpërndarja. Linja e prodhimit ekskluziv ka ndihmuar njerëzit përfaqë botës të duken dhe ndihen më mire. Për informacion shtesë rreth FLP's ju lutem vizitoni: <http://www.foreverliving.com>.

Ju lutem lexoni me kujdes Njoftimin mbi Privatësinë që pason, për të kuptuar qëllimin dhe praktikën tona përsa i përket të dhënave tuaja personale dhe si do të përdoren këto të dhëna personale.

Informacioni Që Mund Të Marrim Prej Jush

Ne mund të mbledhim dhe pëpunojmë informacionin e mëposhtëm rreth jush që ju na jepni, në mënyrë që t'ju ofrojmë eksperiencën më të mirë të mundshme kur ju përdorni shërbimin tonë. Të dhënat personale që mund të duhet të jepni përfshijnë si me poshtë:

- Emër, Mbiemër
- Adresën(at)
- Numrin(at) e Telefonit
- Adresën(at) e Email-it
- Ditëlindjen
- Të dhënat për pagesën (Të dhënat e Kartës së Kreditit)
- Të Dhënat e Llogarisë Bankare
- Numri juaj Personal
- Përshkrimi I Juaj
- Firma(at)
- Emri Bashkëshortit
- Të Dhënat e Bashkëshortit
- Rregjistrim I Telefonatave Të Shërbimit Ndaj Klientit
- Fotografi
- Të Dhëna Të Tjera Të Mbledhura Që Mund T'ju Përkasin Direkt Apo Indirekt

Informacion dhe dokumenta personale shtesë që përmbajnë të dhëna personale mund të merren kohë pas kohe për qëllime biznesi, si për shembull, përlllogaritja e bonuseve. Kjo kategori të dhënash është informacion që ju na e ofroni ne duke kryer disa detyra:

- Aplikimi për tu regjistruar në FLP si Partner I Biznesit Forever (FBO) ose Klient I Preferuar I Foreverit (FPC) nga ndonjë website i FLP-së;
- Blerja e produkteve ose dhënia e porosisë nga ndonjë website i FLP-së;
- Pjesëmarrja në ndonjë kompeticion, promovim apo kërkim;
- Pjesëmarrja në çdo marrëdhënie intervepruese në ndonjërin prej websiteve të FLP's, duke vepruar në forume ose duke dërguar komente dhe vlerësime rreth shërbimeve dhe/ose produkteve;
- Plotësimi I të dhënave te kërkuara nga ndonjë website i FLP-së;
- Raportimi I një problemi nga ndonjë website i FLP-së; ose
- Duke rënë dakord për marrjen e materialeve të marketingut.

FLP është krenare në marrjen pjesë dhe aplikimin e ligjeve federale dhe shtetërore dhe nuk i shpërndan të dhënat tuaja personale me ndonjë kompani të jashtme dhe shitëse, përveçse në lehtësimin e një marrëdhënie të lidhur me biznesin ose transaksioni financiar në anën tuaj.

Për të dhëna personale ofruar një pale të tretë, ky Njoftim mbi Privatësinë aplikohet mbi të dhënat personale vetë kur ne I marrim të dhënat personale nga ju .

Informacione Të Tjera Që Ne Mund Të Mbledhim Rreth Jush

Gjatë secilës prej vizitave në website-in tonë FLP, ne mund të mbledhim informacionin në vazhdim:

- Të dhëna teknike, përfshirë protokollin e internetit (IP) adresën e përdorur nga kompjuteri juaj për tu lidhur me internetin, informacionin tuaj të hyrjes, tipe dhe versione të ndryshme kërкуси interneti, settingun e zones kohore, tipe dhe versione të ndryshme plug in për kërкус interneti, sisteme operative dhe platforma;
- Informacion rreth hyrjeve tuaja, përfshirë Uniform Resource Locators (URL) e plotë, clickstream-in gjithashtu, nëpërmjet dhe nga faqet tona te internetit

(përfshirë datën dhe kohën), produkte që ju keni pare ose kërkuar për kohën që ju është përgjigjur faqja, gabime të shkarkuara, gjatësia kohore në disa faqe, informacione ndërvepruese të faqes (sic janë lëvizja lart-poshtë në faqe, klikimet, dhe vendosja sipër e maus-it), mënyrat e përdorura për t'u larguar nga faqja, çdo numër telefoni i përdorur për të telefonuar shërbimin ndaj klientit dhe çdo adresë email-i e përdorur për tu lidhur me ne.

Informacioni Që Ne Marrim Nga Burime Të Tjera

Ne mund të punojmë nga afër me palë të treta (përfshirë, për shembull, partnerë biznesi, nënkontraktorë në planin teknik, shërbime për pagesa dhe shpërndarje, rrjetet e promovimit, bashkëpunues analitik, kërkues informacioni) dhe mund të marrim informacion rreth jush nga këta ofrues. Ne do t'ju lajmërojmë juve sa herë që marrim informacion rreth jush nga këta ofrues dhe arsyet përse ne do ta përdorim këtë informacion.

Cookies

Cookies janë pjesë të vogla të dhënash që dërgohen nga website-t dhe regjistrohen nga kompjuterat e përdoruesve nëpërmjet faqes të kërkimit të përdoruesit gjatë kërkimit që kryen përdoruesi, për të memorizuar informacionin (si artikuj që shtoni në shportën tuaj elektronike online) ose për të regjistruar aktivitetin kërkues të përdoruesit.

Opsioni "Help" në shumë kërkues interneti do t'ju tregojë juve se si të pengoni kërkuesin tuaj që të pranojë cookies të reja dhe si të lajmëroheni nga kërkuesi i internetit kur ju merrni një cookies të ri, ose si të ç'aktivizoni të gjithë cookies së bashku. Përveç kësaj, ju mund të ç'aktivizoni ose fshini të dhëna të ngjashme shtesë që përdoren nga kërkuesi i internetit, si Flash cookies, duke ndryshuar add-on's settings ose duke shkuar në websitein e prodhuesit të tij.

Për shkak se cookies ju lejon ju të përfitoni prej disa nga elementeve kryesor të FLP-së, ne ju këshillojmë ti lejonit ato.

Nxjerrja e Të Dhënave Tuaja

Informacioni rreth përdoruesve tanë, FBO, ose blerësve është pjesë e rëndësishme e biznesit tonë dhe ne nuk e shesim atë tek të tjerët. Ne shpërndajmë të dhënat personale vetëm në mënyrën që e përshkruajmë më poshtë dhe me filjalet. Ju pranoi

që ne kemi të drejtën e nxjerrjes të të dhënave tuaja personale në varësi të nevojave të aktivitetit të biznesit sipas rrethanave dhe asaj që vjen më poshtë:

- **Nxjerrja e Informacionit të Brendshëm:** Për ne është e domosdoshme ruajtja dhe vënia në dispozicion të të dhënave tuaja për hallka të ndryshme të biznesit tonë, në bazë të nevojave për përdorim në mënyrë efikase për veprimtarinë e biznesit tonë legjitim.
- **Per Arsye Biznesi:** Një sasi e vogël informacioni mund të shpërndahet me individë të tjerë të cilët janë pjesë e, ose duan të bëhen pjesë e, mundësive që ofron biznesi FLP (për shembull, emri juaj i plotë dhe niveli aktual FBO mund të dale në raportet e kualifikimit ose mund ti jepet një FBO-je ,nëse ju jeni pjesë e rrjetit të tyre të mësipërm ose mëposhtëm). Nëse ju përfundoni të qënurit shpërndarës FBO, ky informacion do të fshihet dhe nuk do të shpërndahet më.
- **Ofrimi Shërbimit nga Të Tretë:** Ne punësojmë kompani dhe individë të tjerë për të kryer punë në emrin tonë, Shembujt mund të përfshijnë dërgimin e letrave postare dhe emaile-ve, heqja e të dhënave të përsëritura nga listat e klientëve, analiza e të dhënave , ofrim asistence në marketing, ofrim i rezultateve dhe adresave të kërkimit në internet, përpunimi i pagesave me kartë krediti dhe ofrimi i shërbimit ndaj klientit. Këta ofrues shërbimesh kanë përqasje në të dhëna personale të cilat u duhen për ti përdorur në funksionet e tyre në përputhje me detyrimet kontraktuale, por nuk mund ti përdorin ato për qëllime ose arsye të tjera.
- **Oferta Promovuese:** FLP-ja kurrë nuk shet, tregëton ose jep me qira të dhënat tuaja personale një pale të tretë që nuk ka lidhje me ne, pa marrë dakordsinë tuaj të veçantë. Herë pas here, FLP,mund t'ju dërgojë oferta dhe materiale promovuese për t'ju informuar mbi shërbimet dhe të mirat e tjera që FLP ofron të cilat janë të ngjashme me ato që ju keni blerë dhe kërkuar ose për t'ju lajmëruar rreth ndryshimeve në produktet dhe shërbimet tona. Individët janë të lirë për të hequr dorë nga këto oferta promovuese kur të duan në website-in, nëpërmjet email-it, ose duke kontaktuar me Zyrat Qëndrore me telefon në 1-888-440-ALOE (2563) ose në zyrat lokale në telefonin 00355 69 40 811
- **Mbrotja E FLP-ve Dhe Të Tjera:** Ne japim llogarin dhe informacione të tjera personale kur ne besojmë se dorëzimi është i duhuri dhe në përputhje me ligjin; zbaton ose aplikon rregullat tona të përdorimit dhe marrëveshje të tjera; ose ruan të drejtat, pronat, ose sigurin e FLP-së, klientëve tanë, ose të tjera. Kjo mund të përfshijë shkëmbimin e informacionit me kompani dhe organizata të tjera për mbrotje ndaj mashtrimit dhe zvogëlimin e rrezikut të kreditimit. Qartësisht, që kjo nuk përfshinë shitjen, dhënien me qira, shpërndarjen, ose zbulimin e

informacionit personalisht të indetifikushëm nga konsumatorët për arsye komerciale në kundërshtim me angazhimin e marrë përsipër në këtë Njoftim të Privatësisë.

- **Me Pëlqimin Tuaj:** Përveç atyre të përcaktuara më sipër, ju do të lajmëroheni kur informacion rreth jush do t'i dërgohet palëve të treta dhe ju do të keni mundësinë e zgjedhjes për të mos e shpërndarë informacionin.

Ku I Ruajmë Ne Të Dhënat Tuaja Personale

Informacioni që ne mbledhim nga ju do të transferohet dhe ruhet në, një destinacion në Shtete e Bashkuara, jashtë Zonës Ekonomike Europiane ("EEA"). Gjithashtu do të përpunohet nga staf jashtë EEA-së, që janë të punësuar nga një ose më shumë prej filialeve tona. Kjo përfshin staf të lidhur, ndër të tjera, me plotësimin e blerjeve tuaja, përpunimin e detajeve në pagesat që ju kryeni dhe ofrimin e shërbimit mbështetës. Duke dorëzuar të dhënat tuaja personale, ju pranoni transferimin, ruajtjen ose përpunimin e tyre.

Ne do të ndërmarrim të gjitha hapat e arsyeshme për të siguruar që (1) informacioni juaj të përdoret në mënyrë të sigurtë dhe në përputhje me këtë Njoftim mbi Privatësinë dhe (2) të dhënat që përmbajnë informacion për ju ruhen ose shkatërrohen në përputhje me Politikën Tona Te Brendëshme për Ruajtjen e të Dhënave Globale. Ne mbajmë të dhënat personale për aq kohë sa është e nevojshme për t'ju ofruar Shërbimin që ju keni kërkuar dhe më pas për qëllime biznesi legale ose legjitime legale. Kjo mund të përfshijë periudha mbajtëse (1) të mandatuara nga ligji, kontrata, ose detyrime të tilla që i aplikohen veprimeve të biznesit tonë; (2) për ruajtjen, zgjidhjen, mbrotjen, ose zbatimin e të drejtave të kontratave tona legale; ose (3) nevoja për të mbajtur të dhëna financiare dhe biznesi të sakta dhe adekuate.

I gjithë informacioni që ju na jepni ruhet në servera të sigurtë. Ne mbajmë një varietet të madhë programesh dhe kontroll dhe siguri për të ruajtur të dhënat tuaja. Çdo pagesë transaksioni do të kriptohet duke përdorur teknologjinë Secure Socket Layer (SSL). Ne zbatojmë Payment Card Industry Data Security Standard (PCI DSS), kur përdorim të dhënat e kartës së kreditit. Kur ne ju kemi dhënë juve (ose ju e keni zgjedhur) një fjalëkalim që ju lejon për tu futur në disa pjesë të faqes tonë, ju jeni përgjegjës për ruajtjen e këtij fjalëkalimi. Ne ju kërkojmë të mos e ndani fjalëkalimin me të tjerë. Sigurohuni që të keni dalë nga faqja e internetit kur përfundoni së përdoruri kompjuterin e përbashkët.

Fatkeqsisht, transmetimi i informacionit në internet nuk është tërësisht i sigurtë. Edhe pse ne do të bëjmë më të mirë tonë për të ruajtur të dhënat tuaja personale, ne nuk mund të garantojmë sigurinë e të dhënave tuaja që transmetohen në faqen tonë; çdo

transmetim është përgjegjësi e jotja. Pasi ne marrim të dhënat tuaja, ne do të përdorim procedurë strikte dhe masa sigurie për të ndaluar aksesin e paautorizuar.

Aksesi, Kontrolli Dhe Të Drejtat Tuaja

Në qoftë se krijon një llogari gjatë procesit të regjistrimit, ju mund të shikoni, përditësoni dhe fshini disa të dhëna rreth jush dhe bashkëveprimit tuaj me FLP-në. Nëse dispononi numërin e vërtetimit për blerjen, ju mund të ndërroni dhe përditësoni blerjen tuaj. Nëse ju nuk mund të futeni vetë për të përditësuar të dhënat tuaja, ju gjithnjë mund të kontaktoni FLP-në për ndihmë.

Nëse doni të ushtroni çilëndo prej të drejtave tuaja si subjekt i të dhënave ose të diskutoni të dretat tuaja, ju lutemi na bëni me dije duke përdorur secilën prej kontakteve të informacionit në seksionin “Na Kontaktoni” të këtij Njoftimi mbi Privatësinë. Ne mund tju kërkojmë të identifikoheni me një dokument të vlefshëm për arsye verifikimi. Të drejtat tuaja janë si më poshtë:

- E drejta e aksesit mbi informacionin që ne kemi rreth jush.
- E drejta e korrigjimit, transportueshmëris, fshirjes, kufizimeve dhe kundërshtimit.
- E drejta për të tërhequr dakordsinë në çdo kohë.
- E drejta për të paraqitur një ankesë pranë një autoriteti mbikqyrës.
- E drejta për të ditur pasojat e mosdhënjes së informacionit të nevojshëm.
- E drejta për të mos qënë subjekt i një vendimi bazuar vetëm në përpunimin automatik.

Nëse bëni një kërkesë për të fshirë të dhënat tuaja personale dhe këto të dhëna janë të domosdoshme për produktin ose shërbimin që ju keni blerë, kërkesa do të zbatohet vetëm për sa kohë nuk është më e domosdoshme për çdo shërbim të blerë ose e nevojshme për qëllimet legjitime ose legale të biznesit tone, ose në detyrimin për mbajtjen e të dhënave kontraktuale ose legale.

Mbajtja e të dhënave

Sidoqoftë, çdo FBO (nën nivelin e menaxherit), Klient i Preferuar ose Klient me Pakicë që nuk ka aktivitet llogarie (duke përfshirë, por pa u kufizuar në, shitjet e akredituara, blerjet e produkteve, sponsorizimin ose fitimin e komisioneve dhe/ose bonuset) gjatë çdo periudhe shtatë (7) vjeçare të njëpasnjëshme, do të konsiderohen joaktive dhe do të hiqen të dhënat e tyre ose e turbulluar nga sistemi i FLP-së në përputhje me politikën tonë të ruajtjes së të dhënave.

Politikat e Informimit Online Mbi Fëmijët

FLP nuk ka si qëllim përdorimin e website-ve tona nga cilido që është nën 18 vjeç. Ne nuk tregëtojmë ose mbledhim informacion nga cilido që mund të jetë nën 18 vjeç në dijenin tonë; dhe asnjë nga faqet tona të internetit që mbledh të dhëna (përfshirë, por jo e kufizuar në, regjistrimin, porositë, pjesëmarrjen në aktivitete marketingu dhe kërkesa për kontakte) nuk kanë për qëllim ose duhet të përdoren nga dikush nën moshën 18 vjeç.

Rregullat për Mbrojtjen E Të Dhënave Të Përgjithshme No. 2016/679 (GDPR – EU)

FLP-ja angazhohet për të ofruar një shërbim të mirë ndaj klientit, mbrojtjen e të dhënave tuaja personale dhe ruajtjen e privatësisë tuaj. Nëse ju jeni Rezident i Zonës Ekonomike Europiane (EEA) dhe beson që ne i ruajmë të dhënat e tua personale sipas Rregullores për Mbrojtjen e të Dhënave të Përgjithshme (GDPR) dhe nëse keni pyetje, jeni i pakënaqur në mënyrën se si FLP përdor të dhënat tuaja personale ose se si FLP-ja ka vepruar ndaj një ankese apo kërkesë, ju keni të drejtën për të paraqitur një ankesë autoriteteve mbikëqyrëse. Ju lutemi të ndiqni këtë adresë në internet për të gjetur autoritetin mbikëqyrës më të përshtatshëm në shtetin tuaj EEA:

https://edpb.europa.eu/about-edpb/board/members_en.

Të drejtat e privatësisë specifike të SHBA

FLP është e përkushtuar t'u përmbahet të gjitha ligjeve të zbatueshme të privatësisë në SHBA, duke përfshirë ato të shteteve ose juridiksioneve specifike që japin të drejta shtesë të privatësisë. Për informacion të detajuar në lidhje me të drejtat specifike të privatësisë sipas ligjeve të SHBA si Akti i Privatësisë së Konsumatorit në Kaliforni (CCPA), Akti i Mbrojtjes së të Dhënave të Konsumatorit të Virxhinias (VCDPA), Privatësia e Kolorados Act (ColoPA) dhe të tjerë, ju lutemi klikoni këtu për të parë shtojcën tonë të plotë të të Drejtave të Privatësisë specifike të Shteteve të Bashkuara.

Për çdo juridiksion apo shtet të SHBA-së që nuk renditet në mënyrë specifike në shtojcë, ne do të vazhdojmë të respektojmë të gjithë privatësinë përkatëse ligjeve dhe t'ju japë të drejtat tuaja. Ju lutemi vini re se të drejtat tuaja të privatësisë mund të ndryshojnë pak në varësi të juridiksionit, por ne sigurojmë që të gjithë përdoruesve t'u sigurohet mbrojtje, akses dhe kontroll i fuqishëm mbi të dhënat e tyre personale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për çdo pyetje ose shqetësim në lidhje me të drejtat tuaja të privatësisë ose për të ushtruar të drejtat tuaja sipas ligjit të SHBA-së, mos ngurroni të na kontaktoni sipas udhëzimeve tona në seksionin "Na kontaktoni" më poshtë. Ne do të verifikojmë identitetin tuaj dhe do ta përpunojmë tuajin kërkesë në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. Ju lutemi vini re se ndërsa këto të drejta nuk janë absolute, ne do të ofrojmë pajtueshmëri të plotë aty ku kërkohet.

Për çdo pyetje ose shqetësim në lidhje me të drejtat tuaja të privatësisë ose për të ushtruar të drejtat tuaja sipas ligjit të SHBA-së, mos ngurroni të na kontaktoni sipas udhëzimeve tona në seksionin "Na kontaktoni" më poshtë. Ne do të verifikojmë identitetin tuaj dhe do ta përpunojmë tuajin kërkesë në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. Ju lutemi vini re se ndërsa këto të drejta nuk janë absolute, ne do të ofrojmë pajtueshmëri të plotë aty ku kërkohet.

Të drejtat e privatësisë specifike për një vend të huaj

Ashtu si me të drejtat e privatësisë specifike të shtetit, FLP është gjithashtu e përkushtuar t'u përmbahet të gjitha ligjeve të huaja të zbatueshme për privatësinë, duke përfshirë ato të vendeve ose juridiksioneve specifike që japin të drejta shtesë të privatësisë. Për informacion të detajuar në lidhje me të drejtat specifike, jo-SHBA të privatësisë, si Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR) dhe të tjera, ju lutem shikoni më poshtë.

Jo Shitje të të Dhënave Tuaja Personale: Në dymbëdhjetë muajt që paraprijnë datën hyrëse në fuqi të këtij Njoftim të Privatësisë FLP-ja nuk ka shitur asnjë të dhënë personale të konsumatorëve, sepse këto kushte janë përcaktuar nën Aktin e Privatësisë të Klientit në Kaliforni.

Për çdo vend që nuk renditet në mënyrë specifike më poshtë, ne do të vazhdojmë të respektojmë të gjitha ligjet përkatëse të privatësisë dhe do t'ju japim tuajën të drejtat. Ju lutemi vini re se të drejtat tuaja të privatësisë mund të ndryshojnë pak në varësi të juridiksionit, por ne e sigurojmë këtë të gjithë përdoruesve u sigurohet mbrojtje, akses dhe kontroll i fuqishëm mbi të dhënat e tyre personale në përputhje me ligji në fuqi.

Për çdo pyetje ose shqetësim në lidhje me të drejtat tuaja të privatësisë ose për të ushtruar të drejtat tuaja, mos ngurroni të na kontaktoni sipas udhëzimeve tona në seksionin "Na kontaktoni" më poshtë. Ne do të verifikojmë identitetin tuaj dhe do të përpunojmë kërkesën tuaj në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. Ju lutemi vini re se megjithëse këto të drejta nuk janë absolute, ne do t'i bëjmë të sigurojë pajtueshmëri të plotë aty ku kërkohet.

Lei Geral de Proteção de Dados Nr. 13.709 / 2018 ose Ligji i Përgjithshëm për Mbrojtjen e të Dhënave (LGPD - Brazil)

Përveç angazhimeve të mësipërme të privatësisë, FLP i është përkushtuar përmbyshjes së përgjegjësisë të saj në lidhje me mbledhjen, mbajtjen, përdorimin dhe përpunimin e informacionit tjetër personal që është brenda fushës së LGPD. Të dhëna të tilla personale do të përpunohen vetëm për qëllime të ligjshme dhe të përshtatshme. FLP ka zbatuar masa të dizajnuara për të siguruar sigurinë e informacionit personal dhe për të parandaluar aksesin, fshirjen ose keqpërdorimin e paautorizuar ose aksidental të informacionit personal. FLP do të lehtësojë ushtrimin e të drejtave të subjektit të të dhënave në një mënyrë efektive dhe transparente.

LGPD u jep të drejta e të dhënave të caktuara subjekteve që banojnë në Brazil në lidhje me përpunimin e informacionit personal. FLP është e përkushtuar për të respektuar këto të drejta dhe ka krijuar politika dhe procedura efektive dhe transparente për ta bërë këtë. Të drejtat e të dhënave të një subjekti, në lidhje me informacionin e tij personal, përfshijnë:

- E Drejta për Njoftim. FLP siguron këtë Njoftim të Privatësisë, duke detajuar se si përpunohen informacionet personale, përfshirë entitetet me të cilat FLP mund të ndajë informacionin personal të subjekteve të të dhënave.
- E Drejta për të Revokuar Pëlqimin. Subjektet e të dhënave mund të tërheqin dhënien e pëlqimit në çdo kohë dhe FLP do të ndalojë përpunimin dhe fshirjen e të dhënave të tyre, duke iu nënshtruar të drejtës së FLP për të mbajtur të dhënat siç lejohet për qëllime të ligjshme dhe në përputhje me Politikën e saj të Brendshme të Ruajtjes së Regjistrimit, duke përfshirë edhe respektimin e legjislacionit të saj si dhe detyrimet për ta përdorin atë ekskluzivisht mbi një bazë anonimiteti.
- E Drejta e Aksesit. Subjektet e të dhënave mund të marrin nga FLP konfirmimin nëse të dhënat personale janë duke u përpunuar dhe, nëse ka, qasjen në të dhënat personale.
- E Drejta për Korrigjim / Raktifikim. Subjektet e të dhënave mund të korrigjojnë informacione personale të pasakta ose jo të plota.
- E Drejta e Fshirjes. Subjektet e të dhënave mund ti fshihen të dhënat personale në rrethana të caktuara.
- E Drejta për Kufizimin e Përpunimit. Subjektet e të dhënave mund të kenë të ndaluara përkohësisht përpunimin shtesë të të dhënave personale ndërsa kontestohet saktësia ose përpunimi i të dhënave personale.

- E Drejta për Lëvizjen e të Dhënave. Subjektet e të dhënave mund të jenë në gjendje të marrin të dhëna personale me qëllim që t'i sigurojnë ato të dhëna personale një kontrolluesi tjetër.
- E Drejta për të Kundërshtuar. Subjektet e të dhënave mund të kundërshtojnë, në çdo kohë dhe në bazë të situatës së tyre të veçantë, se përpunimi i të dhënave personale është i panevojshëm ose i tepruar.
- E Drejta për të Shmangur Vendimarrjen Individuale të Automatizuar. Subjektet e të dhënave nuk mund t'i nënshtrohen një vendimi të bazuar vetëm në përpunimin e automatizuar, përfshirë profilizimin, që ka ndikim ligjor ose të ngjashëm.

Nëse dëshironi të ushtroni ndonjë nga të drejtat tuaja si subjekt i të dhënave ose të diskutoni mbi të drejtat tuaja, ju lutemi na tregoni duke përdorur ndonjë nga informacionet e kontaktit në seksionin "Na Kontaktoni" të këtij Njoftimi për Privatësinë. Ne mund t'ju kërkojmë të na tregoni një formë të vlefshme identifikimi për qëllime verifikimi.

FLP është e përkushtuar të ofrojë shërbime të shkëlqyera për klientët, duke mbrojtur informacionin tuaj personal dhe duke respektuar privatësinë tuaj. Nëse jeni banor i Brazilit dhe besoni se ne i mbajmë informacionet tuaja personale sipas LGPD dhe keni një pyetje, jeni të pakënaqur në lidhje me trajtimin e informacionit tuaj personal nga FLP, ose mënyrën se si FLP ka trajtuar një ankesë ose kërkesë, ju keni e drejta për të paraqitur një ankesë tek autoriteti kombëtar, i njohur gjithashtu si Autoriteti Kombëtar i Mbrojtjes së të Dhënave ose ANPD.

The Ley Federal de Protección de Datos Personales en Posesión de los Particulares (LFPDPPP – Mexico)

Përveç angazhimeve të mësipërme të privatësisë, individët që banojnë në Meksikë mund të kenë të drejtën sipas LFPDPPP të kërkojnë qasje në informacionin personal, korrigjimin e informacionit personal, anulimin e informacionit personal ose kundërshtimin e përpunimit të informacionit personal ("Të drejtat e ARCO"). Nëse dëshironi të ushtroni ndonjë të drejtë të ARCO, ju lutemi na tregoni duke përdorur ndonjë nga informacionet e kontaktit në seksionin "Na Kontaktoni" të këtij Njoftimi për Privatësinë. Ne mund t'ju kërkojmë të siguroni një formë të vlefshme identifikimi për qëllime verifikimi.

Akti i Privatësisë nr. 119 1988 (Akti i Privatësisë - Australi)

Për konsumatorët Australianë, nëse FLP dështon t'i përgjigjet një kërkesë ose ankesë të subjektit të të dhënave brenda një periudhe të arsyeshme pas marrjes me shkrim, ose nëse nuk jeni të kënaqur me përgjigjen që merrni nga ne, ju mund të paraqisni një ankesë pranë Zyrës së Komisionerit Australian të Informacionit ("OAIC"). Detajet se si të kontaktoni OAIC gjenden në www.oaic.gov.au.

Ligji i Kanadasë për Mbrojtjen e Informacionit Personal dhe Dokumentet Elektronike (PIPEDA) dhe Aktet e Mbrojtjes së Informacionit Personal të Albertës dhe British Columbia(PIPA)

Ligji i Kanadasë për Mbrojtjen e Informacionit Personal dhe Dokumentet Elektronike (PIPEDA) dhe Informacionin Personal Akti i Mbrojtjes (PIPA) për Albertën dhe Kolumbinë Britanike, vendos standarde për praktikatat e privatësisë në sektorin privat për subjektet e mbuluara. Individët e qeverisur nga këto ligje të privatësisë kanë të drejtë të shohin informacionin që kanë kompanitë rreth tyre si dhe të kërkojë korrigjime. Individët gjithashtu mund të:

- Pyetni për mbledhjen ose përdorimin e informacionit personal nga një organizatë;
- Kërkoni këshilla se kush brenda organizatës është përgjegjës për mbrojtjen e personave informacion;
- Presin që organizatat të përdorin, mbledhin ose zbulojnë të dhënat personale në mënyrën e duhur;
- Presin që organizatat të ndjekin pëlqimin në lidhje me të dhënat personale dhe t'i përmbahen siç duhet procedurat dhe teknikat e mbrojtjes; ose
- Raportoni menaxhimin e të dhënave personale brenda një organizate nëse shkelen të drejtat e privatësisë.

Ne nuk mund t'i përgjigjemi kërkesës suaj ose t'ju ofrojmë informacion personal nëse nuk mund të verifikojmë identitetin tuaj ose autoriteti për të bërë kërkesën dhe për të konfirmuar se informacioni personal lidhet me ju. Ju lutemi vini re se të drejtat e mësipërme nuk janë absolute, dhe ne mund të kemi të drejtë të refuzojmë kërkesat, tërësisht ose pjesërisht, kur përjashtimet sipas zbatimit zbatohet ligji.

Akti i Mbrojtjes së të Dhënave Personale Dixhitale të Indisë (DPDPA) 2023

Akti i Mbrojtjes së të Dhënave Personale Dixhitale të Indisë (DPDPA) 2023 zbatohet për të gjitha subjektet e përfshira në mbledhjen, përpunimin ose ruajtjen e të dhënave personale brenda Indisë. Kjo përfshin bizneset indiane, kompanitë e huaja që ofrojnë mallra ose shërbime në Indi, dhe individë që trajtojnë të dhënat personale për qëllime komerciale. Në thelb, kushdo që vepron brenda Indisë peizazhi dixhital duhet t'u përmbahet dispozitave të këtij legjislacioni.

Sipas DPDPA, individët (subjektet e të dhënave) kanë të drejta specifike në lidhje me të dhënat e tyre personale:

- Qasja dhe transparenca: Ju keni të drejtën të dini se çfarë të dhënash personale mbajmë për ju, duke përfshirë detaje mbi kategoritë e të dhënave të mbledhura, qëllimet e përpunimit dhe palët e treta me të cilët ndahet.
- Saktësia dhe korrigjimi: Mund të kërkonti korrigjim të çdo personali të pasaktë ose jo të plotë të dhënat që mbajmë. Ne jemi të detyruar t'i hetojmë dhe adresojmë këto kërkesa menjëherë.
- Fshirja dhe kontrolli: Në kushte të caktuara, ju keni të drejtë të kërkonti fshirjen tuaj të dhënave personale nëse nuk nevojiten më për qëllimin e synuar ose nëse tërhiqni pëlqimin.
- Kufizimet e përpunimit: Ju mund të kufizoni mënyrën se si ne i përpunojmë të dhënat tuaja, duke përfshirë qëllimet për të cilat mund të përdoret ose kush mund t'i qaset.
- Kundërshtim & Zgjedhja: Ju keni të drejtën të kundërshtoni aktivitetet specifike të përpunimit të të dhënave, si p.sh marketing i drejtpërdrejtë. Ne do të ofrojmë opsione të qarta të tërheqjes.
- Transportueshmëria dhe pronësia e të dhënave: Ju mund t'i kërkonti të dhënat tuaja personale në një mënyrë që ju lejon transferojeni atë te një ofrues tjetër shërbimi.
- Pëlqimi dhe tërheqja: Ju keni të drejtë të tërhiqni pëlqimin tuaj për përpunimin e të dhënave në çdo kohë. Ne garantojmë që ky proces të jetë i drejtpërdrejtë dhe ju informojmë për çdo pasojë.
- Ankesa dhe Përgjegjësia: Nëse besoni se të drejtat tuaja të të dhënave janë shkelur, mund të paraqisni një ankesë me Bordin e Mbrojtjes së të Dhënave të Indisë. Ne jemi të përkushtuar të respektojmë DPDPA dhe të qenit përgjegjës për praktikatat tona të të dhënave.

Për më shumë informacion mbi mënyrën e ushtrimit të këtyre të drejtave, ju lutemi referojuni detajeve tona të kontaktit të dhëna në këtë Privatësi Njoftim. Ne nuk mund t'i përgjigjemi kërkesës suaj ose t'ju ofrojmë informacione personale nëse nuk mund t'ju verifikojmë identitetin ose autoritetin për të bërë kërkesën dhe për të konfirmuar se informacioni personal lidhet me ju. Ju lutemi vini re se të drejtat e mësipërme nuk janë absolute dhe ne mund të kemi të drejtë të refuzojmë kërkesat, tërësisht ose pjesërisht, ku përjashtime sipas zbatohet ligji në fuqi.

Përdorimi i inteligjencës artificiale (AI).

FLP mund të përdorë teknologjitë e inteligjencës artificiale (AI), duke përfshirë, por pa u kufizuar në, zgjidhjet gjeneruese të AI dhe chatbots, për të përmirësuar përvojën tuaj në faqen tonë të internetit dhe për të përmirësuar shërbimet tona. Duke përdorur faqen e internetit të FLP-së, ju pranoni dhe bini dakord që nëse zgjidhni t'i jepni informacion një platforme të teknologjisë AI, ju e bëni këtë sipas dëshirës tuaj diskrecionin dhe rrezikun e vet. Ju jeni vetëm përgjegjës për informacionin që jepni, dhe ne nuk do të jemi përgjegjës për të çdo pasojë që rrjedh nga këto zbulime. Për më tepër, FLP nuk mund të mbahet përgjegjëse për asnjë vendim bërë bazuar në rezultatet e krijuara nga teknologjitë e AI. Ne ju inkurajojmë të jeni të vëmendshëm kur ndani informacion me këto sisteme.

Ndryshimet Në Njoftimin Mbi Ruajtjen E Privatësisë Tonë

Ne ruajmë të drejtën për të ndryshuar këtë Njoftim mbi Ruajtjen e Privatësisë në çdo kohë. Në rast se ne vendosim për të ndryshuar Njoftimin mbi Ruajtjen e Privatësisë Tonë, ne do ti publikojmë këto ndryshime të ky Njoftim mbi Privatësinë dhe në çdo vend tjetër që ne quajmë të përshtatshëm, në mënyrë që ju të jeni të vetëdijshëm se çfarë informacioni ne mbledhim, si e përdorim atë dhe në çfarë rrethanash, në rast se ka, e nxjerrim atë. Në rast se ka ndryshime thelbësore tek ky Njoftim mbi Privatësinë, ne do t'ju bëjmë me dije këtu, me anë të email-it, ose me mjetet e njoftimit në faqen tonë zyrtare.

Politika e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve

Nëse vendosni të jepni informacione personale në FLP, ose përdorni faqen tonë të internetit ose të merrni pjesë në biznesin tonë, përdorimi juaj dhe çdo mosmarrëveshje mbi privatësinë që nuk mund të zgjidhet në mënyrë miqësore i nënshtrohet këtij Njoftimi të Privatësisë dhe procedurës së përshkruar në [Politikën tonë të Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve](#), e disponueshme nga duke klikuar në hiperlidhje.

Na Kontaktoni

Në qoftë se keni pyetje që lidhen me privatësinë, shqetësime, ose ankesa rreth Njoftimit mbi Ruajtjen e Privatësisë tonë, ose si i trajtojmë të dhënat tuaja personale, ju mund të kontaktoni Zyrën tonë të Brendshme me një nga mënyrat e mëposhtme:

Me e-mail në: privacy@foreverliving.com

Me telefonë në: 1-888-440-ALOE (2563)

Për më tepër, ju gjithashtu mund të kontaktoni në zyrën tuaj lokale të FLP si më poshtë:

Me e-mail në: porosite@foreveralbania.com

Me telefonë në: 00355 69 40 811

Këto email-e monitorohen dhe menaxhohen në mënyrë aktive që të mund të ofrojmë një përvijë që ju mund t'i besoni. Ne do t'i përgjigjemi të gjitha kërkesave, pyetjeve ose shqetësimeve brenda kornizës kohore të specifikuar nga ligji i veçantë i privatësisë që

është subjekt i kërkesës. Nëse nuk jeni të kënaqur me përgjigjen tonë, ju mund të drejtoni ankesat e privatësisë tek autoriteti juaj lokal për mbrojtjen e të dhënave.

Për kërkesat e transportit së të dhënave, ne do të zgjedhim një format për të siguruar informacionin tuaj personal që është i përdorshëm dhe duhet t'ju lejojë të transmetoni informacionin nga një entitet në tjetër.

Ne jemi të përkushtuar të punojmë me ju për të marrë një zgjidhje të drejtë të çdo ankese ose shqetësimi në lidhje me privatësinë. Ne bashkëpunojmë me autoritetet e vendit për mbrojtjen e të dhënave nëse ata besojnë se ka ndodhur një çështje përse i përket privatësisë.